

Të nderuar pjesëmarrës,

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në këtë tryezë të rrubullakët mbi censin e popullsisë dhe banesave 2020. Një falendarim të vecantë shkon për UNDP – Programin për zhvillimin i Kombeve të Bashkuara i cili na ka mbështetur për organizimin e këtij takimi.

INSTAT në tetor të vitit 2020 ka planifikuar të kryejë Censin e Popullisë dhe Banesave i cili është një nga operacionet statistikore më të mëdha dhe të rëndësishme në vend. Instituti i Statistikave, do të angazhojë të gjithë stafin e tij për të zhvilluar me seriozitetin maksimal këtë proces statistikor, i cili jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, konsiderohet më i rëndësishmi në vend nga pikëpamja e llojit të informacionit statistikore që ai mbledh pasi Censi është bazë për përmirësimin e të dhënave socio-ekonomike në vend dhe ndërtimin e një sistemi të shëndoshë statistikor.

INSTAT është duke punuar intesivisht më të gjithë grupet e interesit që do të angazhohen në këtë proces me qëllim që ky Cens të jetë sa më afër, jo vetëm realitetit shqiptar por edhe standardeve ndërkombëtare.

Sic tashmë jeni ne dijeni, gjatë kësaj periudhe INSTAT ka zhvilluar një sërë tryezash të rrumbullakëta me grupet e interesit, për draftimin e pyetësorit të Cens, me qëllim evidentimin e kërkesave, vërejtjeve apo sugjerimeve të këtyre grupeve. Këto takime, do të vijojnë edhe më tej në të ardhmen për të patur një pyetësor jo vetëm me standarde ndërkombëtare por edhe gjithëpërfshirës me përdoruesit vendas të të dhënave të Censit.

Të dhënat mbi dizabilitetin të mbledhura në vitin 2011 në fakt janë kërkuar gjerësisht nga përdorues të ndryshëm si organizata qeveritare, entitete publike apo kërkues të tjerë. Ndaj dhe ne e shohim me interes mbledhjen e informacionit edhe në këtë cens, pasi ato duhet ti shërbejnë një vendim-marrje më të mirë në funksion përmirësimit të kushteve dhe standardeve për këto grupe interesi.

INSTAT do të kryejë një prezantim mbi pyetjen e disabilitetit si dhe rekomandimet ndërkombëtare që jepen mbi mbledhjen e informacionit. Më pas do të diskutojmë mbi mënyrat e mbledhjes së këtij informacioni si dhe problematikat e shfaqura më parë për të dakordësuar dhe eliminuar ato në këtë Cens. Kontributi juaj do të jetë mjaft i vlefshëm për ndërtimin e një pyetësori, të pranueshëm dhe me standarde ndërkombëtare.

Faleminderit!